

Njoftim për aplikim për licencim

Në zbatim të nenit 43, pika 1 dhe 136, pika 2, e ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, njoftojmë se shoqëria “KRONOS KONSTRUKSION” shpk, ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në afërsi të Fshatit Vërnik, Njësia Administrative Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, Qarku Korçë.

Në mbledhjen e datës 10.08.2026, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me kërkesën për licencim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve (nga data 11.08.2026 deri më 09.09.2026), pranë zyrave të ERE-s, në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr.7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.